

FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

RREGULLORJA

MBI ORGANIZIMIN E PUNËS SË KUVENDIT TE PERGJITHSHEM TË FEDERATES SE MUNDJES SE KOSOVES

Prishtine, 2022

Në bazë të nenit 29 pika 2 të Statutit të Federates se Mundjes se Kosoves në mbledhjen e vetë të mbajtur me 06.10.2022, pas shqyrtimit të ndryshimeve dhe plotësimeve, aprovon :

RREGULLORËN

MBI ORGANIZIMIN E PUNËS SË KUVENDIT TE PERGJITHSHEM TË FEDERTAES SE MUNDJES SE KOSOVES”

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Federates se mundjes se Kosoves”

Neni 2


Kuvendin e Pergjithshem te FMK-se e e perbejen:delegatet,trajnerte dhe sportistat e meritur

Neni 3

Puna e Kuvendit të Pergjithshem e FMK-se realizohet në mbledhjet e rregullta dhe zgjedhore. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të FMK-se mbahen një herë në vit, sipas rregullit në fillim të çdo viti kalendarik.

Mbledhjet zgjedhore të Kuvendit te FMK-se e mbahen në çdo 4 vite dhe atë më se voni 30 ditë pas skadimit të mandatit te anëtarëve të Kuvendit.

Emrimet dhe shkarkimet e Kryetarit dhe organeve tjera bëhen në bazë të nenit 18 të kësaj Rregulloreje dhe nenit 39 të Statutit te FMK-se.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

II. PËRGADITJA DHE THIRRJA PËR MBLEDHJE TË KUVENDIT

Neni 4

Thirrja për mbledhjen e Kuvendit të FMK-se e me propozimin e rendit të ditës dhe materialin gjegjës, iu dërgohet anëtarëve të Kuvendit më se voni 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Neni 5

Mbledhja e Kuvendit të Federatës së mundjës të Kosovës, mund të mbahet në qoftë se në mbledhje marrin pjesë më shumë se $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të Kuvendit të FMK-se
Në rast se vërtetohet se në mbledhje nuk marrin pjesë numri i duhur i anëtarëve, mbledhja e Kuvendit të FMK-se, shtyhet dhe e njëjta thirret në afatin prej 7 ditëve.


III. UDHËHEQJA E PUNËS DHE VENDOSJA NË MBLEDHJET E KUVENDIT

Neni 6

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Federatës së mundjës së Kosovës, i udhëheqë Kryetari i FMK-se ose në mungesë të tij personi të cilin ai e cakton.
Mbledhjet zgjedhore të Kuvendit të FMK-se, i udhëheqë Kryesia e punës, e cila zgjedhet në mbledhjen e FMK-se
Kryesinë e punës e propozon dhe të njëjtën e udhëheqë Kryetari i Federatës të përbërjes së gjërtanishme, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Neni 7

Para fillimit të mbledhjes, Kryetari vërteton numrin e anëtarëve të Kuvendit që janë prezent dhe që mungojnë dhe njofton të pranishmit se në mbledhje prezentojnë numër i duhur i anëtarëve për marrjen e vendimeve të plotëfuqishme.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTETËRIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Neni 8

Në mbledhjen zgjedhore të FMK-se, para caktimit të rendit të ditës, zgjedhet Kryesia e punës, Komisioni për verifikimin e anëtarëve të Kuvendit, Komisioni verifikues, Komisioni kandidues, procesmbajtësi dhe verifikuesi të tij.

Neni 9

Në mbledhjen zgjedhore të Federatës së mundjes së Kosovës marrin pjesë me të drejtë vote vetëm delegatet e rinj të Kuvendit.

Neni 10

Kryetari i FMK-se në pajtim me rendin e ditës të propozuar në thirrjen për mbledhjen e Kuvendit, e hapë diskutimin për rendin e ditës, dhe pas kesaj e aprovon atë rend dite.

Neni 11


Anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, të shtojnë pyetje të kërkojnë shpjegime dhe përgjigje.

Neni 12

Shqyrtimi mbi pikat e veçanta të rendit të ditës udhëheqet sipas rregullit, së pari në parim, e pastaj në veçanti, gjegjësisht sipas pjesëve.
Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon Kryetari. Kryetari mund të propozojë që koha e shqyrtimit të diskutimit të kufizohet.

Neni 13

Nëse është e nevojshme që mbi disa çështje të veçanta të shqyrtohet dhe të vendoset, atëherë duhet të bëhet shpjegim hyrës. Kryetari i FMK-se do të caktojë raportuesin, i cili në pika të shkurtëra do të paraqesë pjesën hyrëse dhe do të japë arsyetimet.
Kryetari mund që gjatë shqyrtimit të kërkojë që raportuesi ose përpunuesi i materialit, të japë shpjegime plotësuese.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Neni 14

Anëtarët e Kuvendit të FMK-se gjegjësisht personat tjerë, të cilët janë të thirrur në mbledhje, marrin pjesë në diskutime sipas rendit të paraqitur. Kryetari mund t'i japë fjalën pa rend raportuesit apo personit tjetër të thirrur, kur vlerëson të nevojshme për shjarime plotësuese, apo për plotësimin e propozimit për të cilin diskutohet.

Neni 15.

Askush nuk mund të merr pjesë në diskutim para se t'ia jap fjalën Kryetari, të ndërhyjn në fjalë pjesëmarrësist në diskutim, apo ndonjë mënyrë tjetër të pengojë punën e Kuvendit. Kryetari ka të drejtë që personi i cili e pengonë punën normale të mbledhjes, ti apë vërejtje, tia marrë fjalën, e në raste të prishjes së rendit të ditës, ta largojë nga mbledhja.

Neni 16

Diskutimi sipas pikave të rendit të ditës, sipas rregullës zgjatë deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve. Kryetari mbyllë diskutimin dhe propozonë që të kalohet në vendosje. Në bazë të propozimeve dhe mendimeve të paraqitura në diskutime dhe propozimeve në material, Kryetari apo raportuesi i formulonë rezymet apo vendimet dhe të njëjtat i paraqet në votim.

Neni 17

Mbi propozimet vendoset me votim, i cili mund të jet i hapur apo i fshehtë, mbi të cilën mënyrë vendosë kuvendi FMK-se
Votimi i hapt bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numrim.
Votimi i fshehtë bëhet me fletëza. rezultatet e votimit të fshehtë i vërtetonë Komisioni i veçant, të cilin e formonë Kuvendi i FMK-se. Vendimi konsiderohet i aprovuar, nëse për atë deklarohen më shumë se gjysma e anëtarëve present, 50%+1.


IV. ZGJEDHJA E ORGANEVE TË FEDERATES SE MUNDJES TE KOSOVES

Neni 18

Në mbledhjen zgjedhore të Kuvendit të FMK-se verifikohet mandati dhe zgjedhën organet:

- Kryetari i FMK-se
- Bordi Drejtues dhe
- Këshilli Mbikëqyrës.

Shkarkimin e këtyre organeve e bënë Kuvendi i FMK-se për shkak të mosëkryerjes së detyrave ,mosërespektimit të Statutit të FMK-se, dhe ligjit të Sportit.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHITËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Neni 19

Verifikimin e mandatit të anetareve të posazgjedhur e vërtetonë Kuvendi në bazë të raportit të Komisionit verifikues. Komisioni verifikues përbëhet prej 3 anëtarëve të zgjedhur në Kuvend.

Neni 20

Kryetarin e FMK-se, e zgjedhë Kuvendi nga radhet e anëtarëve në bazë të dispozitave Statutare. Dy të tretat të anëtarëve në Këshillin Drejtues i zgjedhë në propozim të anëtarëve Kuvendi, kurse një të tretën e anëtarëve të Këshillit Drejtues i emronë Kryetari i FMK-se. Këshilli Mbikëqyrës e zgjedh Kuvendi në bazë të propozimeve të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 21

Komisionet e nevojshme për kryerjen e punëve të caktuara i zgjedhë Këshilli Drejtues i posazgjedhur në mbledhjet e veta pas Kuvendit.

V. PROCESVERBALET


Neni 22

Në mbledhjet e Kuvendit të FMK-se, mbahet procesverbali. Procesmbajtësin dhe verifikuesin e procesverbalit e propozon Kryesia e punës të Kuvendit të FMK-se.

Neni 23

Procesverbali mbi punën e Kuvendit përmbanë të dhënat themelore, dhe këtë:

- ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes,
- shenjen dhe numrin e mbledhjes,
- numrin e anëtarëve të Kuvendit prezent dhe joprezent,
- personat tjerë prezent,
- emrin e Kryesuesit, emrin e procesmbajtësit dhe verifikuesit të procesverbalit,
- rendi i ditës,
- emrat e pjesëmarrësve në diskutime me përmbajtje të shkurtër të diskutimeve,
- rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës,
- mendimet e ndara të anëtarëve në Kuvend dhe çështjet tjera me rëndësi. Në fund të çdo pike të rendit të ditës shenohet përfundimi sipas rendit të formulimit, ashtu si e ka paraqitur Kryetari.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Neni 24

Procesverbali përpunohet në origjinal dhe në numër të mjaftueshëm të përskrimit. Procesverbalin origjinal e nënshkruan Proçesmbajtësi,verifikuesi i proçesverbalit dhe Kryetari i FMK-se, dhe i njejt i me materialin tjetër ruhet në arkivin e FMK-se.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Çështjet të cilat nuk janë përfshir me këtë Rregullore, rregullohen me vendime të veçanta, të cilat i bie Kuvendi i FMK-se, në bazë të Statutit.

Neni 26

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe zbatohet në Kuvendin, në të cilin është aprovuar

Neni 27

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorje, pushon të vlejë rregullorja nga Kuvendi i kaluar të FMK-se.

Prishtine, 06.10.2022

